



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2024:001776

Datë: 12.03.2024

Numri i dokumentit: 05440355

C.nr.2175/22

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja Blerina KURTAJ, në çështjen juridike kontestimore sipas padisë së paditësit F.V., nga Gjakova, të cilin me autorizim e përfaqëson Dardan Morina, avokat në Prizren, rruga “...” numër 4, e paraqitur kundër të paditurës Komuna e Gjakovës-Drejtoria Komunale e Arsimit, në çështjen juridike: kompensim mbi bazën e përqindjes së inflacionit, jashtë seancës, më 13 Mars 2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditësit F.V., nga Gjakova.

II. DETYROHET e paditura Komuna e Gjakovës - Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit së lartcekur t’ia paguaj në emër të pagesës shtesë - përqindjes së inflacionit shumë prej 537.19 euro, shumë kjo e cila i referohet periudhave si në vijim:

- për periudhën Janar – Nëntor 2022 shumë prej 537.19 euro;
të gjitha me kamatë ligjore prej 8% nga data 05.12.2023 (data e paraqitjes së padisë) deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës në shumë të përgjithshme prej 124.00 euro, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit.

III. REFUZHET pjesa tjetër e kërkesëpadisë mbi shumë e gjykuar si në pikën II të këtij aktgjykimi, dhe atë në shumë prej 42.94 euro, si e pabazuar.

A r s y e t i m

Paditësi përmes të autorizuarit të tij në padinë e parashtruar në gjykatë me datë 05.12.2023 ka parashtruar se është në marrëdhënie pune me të paditurën në shkollën “...”, në fshatin Komuna e Gjakovës. Ka shtuar se me nenin 35 paragrafi 10 të Kontratave Kolektive të Arsimit në Kosovë, parashihet se “Për çdo vit përcillet shkalla e inflacionit...[]...dhe përqindja të futet në pagë”. Andaj, meqenëse e paditura nuk i ka përmbushur pagesën e përqindjes në emër të inflacionit, ka kërkuar nga gjykata që ta aprovoj kërkesëpadinë e paditësit në tërësi të bazuar, duke e detyruar të paditurën që paditësit t’ia kompensoj shtesën në pagë në emër të inflacionit sikurse në kërkesëpadinë të parashtruar me datë 05.12.2023.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura përmes të autorizuarës se saj në përgjigje në padi të paraqitur në këtë gjykatë me datë 12.01.2024, në të cilën ka parashtruar se kontrata kolektive në të cilën janë thirrë paditësit nuk ka fuqi ligjore ngase është në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi nga Ligji i Punës. Ka shtuar se kërkesa për pagesën e shpërblimit në bazë të inflacionit në pagë nuk i takon paditësit më asnjë dispozitë ligjore e cila rregullon marrëdhënien e punës. Ka shtuar se kërkesa e paditësit është e parashkruar në kuptim të nenit 87 të Ligjit të Punës. Tutje ka parashtruar se Komuna e Gjakovës nuk ka qenë nënshkruese e kontratës kolektive të arsimit, andaj edhe kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar në raport me të paditurën Komuna e Gjakovës. Tutje ka theksuar se kërkesëpadia e paditësit është në kundërshtim me nenin 5, 37 dhe 38 të Kontratës Kolektive të Arsimit, e po ashtu është në kundërshtim me nenin 46, paragrafi 1, 2, 3, 5, 7, dhe 9 të Kontratës Kolektive të Arsimit. Me propozim për gjykatën që konform nenit 399 të Ligjit të Procedurës Kontestimore ta refuzoj kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar (për me tepër sikurse në përgjigjen në padi të datës 12.01.2024).

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 398 dhe 399 të LPK-së, gjeti se janë plotësuar kushtet për dhënien e aktgjykimit jashtë seancës dhe erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e themeltë dhe si e tillë pjesërisht u aprovua.

Nga parashtrimet e palëve ndërgjyqëse të paraqitura me padi, dhe përgjigjes në padi, gjykata ka gjetur se nga Kontrata e punës për paditësin e lëshuar nga Komuna e Gjakovës – Drejtoria e Arsimit, këtu e paditura, vërtetohet fakti se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura në shkollën “...” në fshatin ... Komuna e Gjakovës, si mësimdhënës. Bazuar në Listën e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës vërtetohet se lartësia e pagës bazë së paditësit është shuma prej 421.00 euro. Po ashtu gjykata bazuar në Indeksin e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit i publikuar nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, ka vërtetuar se shkalla e inflacionit për vitin 2022 ka qenë 11.60%. Provave të lartcekura gjykata iu falë besimin e plotë ngase është bërë e besueshme fuqia provuese e tyre, duke u bazuar edhe në nenin 329 paragrafi 1 të LPK-së, i cili përcakton se *“Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”*.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë duhet të zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK), të nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, e cila ka hyrë në fuqi me datë 18.04.2017 dhe asaj të datës 22.01.2021 e cila ka qenë në fuqi deri me datë 21.11.2022, ku në mënyrë identike në nenin 35 par.10 kanë përcaktuar se *“Për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja (%) e inflacionit të futet në pagë”*, ashtu që gjykata erdhi në përfundim se në rastin konkret paditësit i takon e drejta në pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit, si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, pasi që një dispozitë e tillë është e karakterit imperativ dhe si e tillë do të duhej që shkalla e inflacionit të llogaritet në pagë, marrë parasysh që nga lista e pagave që gjendet në shkresat e lëndës, nuk rezulton që një pagesë e tillë është kryer nga e paditura.

Sa i përket lartësisë së kërkesëpadisë, gjykata vendosi duke pasur parasysh të dhënat e nxjerra nga Enti i Statistikave të Kosovës sa i përket shkallës mesatare vjetore të inflacionit, për vitin 2022(*brenda kërkesës së paditësit*) sipas përlllogaritjes si në vijim:

- Për periudhën janar - nëntor 2022, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 11.60 %, andaj duke e llogaritur në pagën bazë të paditësit e cila në vitin 2022 ka qenë 421.00 euro, i bie që shuma e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë për

periudhën 11 mujore në total të jetë 537.19 euro, apo 48.84 euro për muaj
($421 * 11.60\% * 11 = 537.19$)

Duke qenë se mes palëve nuk është kontestuese gjendja faktike përkatësisht se paditësi është i punësuar tek e paditura dhe se në periudhën nga data 01.01.2022 deri me datë 21.11.2022 në pagën e paditësit nuk është përfshirë edhe shkalla e caktuar e inflacionit, të cilat fakte nuk i ka kontestuar as e paditura në përgjigjen në padi, edhe përkundër faktit se e njëjta e ka kundërshtuar kërkesëpadinë, gjykata erdhi në përfundim se janë plotësuar kushtet për dhënien e aktgjykimit jashtë seancës konform nenit 398 të LPK-së ku parashihet që *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritore, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”*, për çka vendosi si në pikën I dhe II të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata vlerësoi pretendimin e të paditurës në lidhje me mungesën e bazës ligjore të kërkesëpadisë me arsyetimin se Ligji i Punës nuk e ka paraparë pagesën e kompensimit mbi bazën e inflacionit, mirëpo këtë pretendim e refuzoi për shkak se baza e kërkesëpadisë rrjedh nga Kontrata Kolektive e Arsimit, e cila bazohet në Ligjin nr.03/L-212 të Punës. Ndërsa sa i përket pretendimit se e paditura nuk është nënshkruese e kësaj kontrate, një pretendim të tillë e refuzoi për arsye se Kontrata Kolektive e Arsimit është e nënshkruar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, andaj prodhon efekt juridik ndaj punëdhënësve të cilët kanë të punësuar punëtorë që të drejtat e tyre burojnë nga kjo kontratë, në rastin konkret e paditura është punëdhënëse e paditësit dhe detyrohet për përmbushjen e detyrimeve që dalin nga kjo kontratë për paditësen.

Gjykata për këtë çështje ka vlerësuar se si moment/periudhë e rrjedhës së kamatës për kërkesat regresuese të kreditorit, duhet të merret data e parashtrimit të kërkesës së kreditorit tek debitori (data e pranimit të kërkesës nga ana e debitorit), apo data e parashtrimit të padisë në gjykatë për rastet kur kreditori nuk ka paraqitur paraprakisht një kërkesë të tillë tek debitori. LMD me dispozitën e nenit 382 paragrafi 1 ka përcaktuar detyrimin e pagesës së kamatëvonesës: *“Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën”*, ndërsa në paragrafin 2 të të njëjtit nen është përcaktuar se: *“Lartësia e kamatëvonesës është tetë përqind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë”*, në rastin konkret, duke qenë se debitori vetëm në momentin e pranimit të padisë nga gjykata është njohur

me përmbajtjen e detyrimit për pagesën e kërkesës regresuese të kreditorit, gjykata si moment të rrjedhjes së kamatës së kreditorit ka marrë datën 05.12.2023, kur është parashtruar padia dhe mbi këtë bazë ka refuzuar shumën prej 42.94 euro, si shumë e kamatës vjetore për vitin 2022 e cila ishte paraqitur bashkë me kërkesën kryesore si vlerë e përgjithshme.

Lartësia e kamatës së përcaktuar prej 8%, i referohet nenit 382 të LMD-së dhe kamata është llogaritur nga dita e parashtrimit të padisë.

Vendosja lidhur me shpenzimet e procedurës u bazua në nenin 452 të Ligjit të Procedurës Kontestimore, ashtu që paditëses iu njohën shpenzimet në shumë prej 124.00 euro, shpenzime këto të cilat iu referohen shpenzimeve si në vijim: për përpilimin e padisë shumën prej 104.00 euro, si dhe për takse gjyqësore për padi, shumën prej 20.00 euro.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Departamenti i Përgjithshëm

C.nr.2175/23, më 13 Mars 2024

GJ Y Q T A R J A

Blerina KURTAJ

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes në dorëzim, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në ekzemplarë të mjaftueshëm për palët dhe gjykatën.

Numri i lëndës: 2024:001776
Datë: 12.03.2024
Numri i dokumentit: 05440355